

RAPORT TEKNIK

(Projekti i Infrastruktures)

Titulli i Projektit:

**REHABILITIMI I SHESHIT “AHMET ZOGU” DHE PARKU “GERALDINE’ NE QYTETIN
E BURRELIT**

1 OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË QYTETIT TË BURRELIT

1.1 Te dhenat ekzistuese

I. Rehabilitimi dhe rivitalizimi i Parkut "Geraldine". Sipërfaqja e parkut është afërsisht 30000 m², në të cilin përfshihen një Xhami, një bar privat, Pallati i Kulturës së Burrelit. Parku "geraldinë është në gjendje të mirë, gjithsesi në brendësi të tij ka adisa zona dhe pasazhe të brendshme të cilat janë të dëmtuara të cilat kanë nevojë për rehabilitim. Gjithashtu ka zona të cilat duhet të ridizenjohen.

II. Rikonceptimi i sheshit përpara bashkisë së qytetit.

Ky shesh ka një sipërfaqe afërsisht 4900m². E gjithë kjo zonë është e shtruar me asfalt. Kjo zonë duhet të marri në konsideratë nevojat e bashkisë siç janë rruga hyrëse për në Bashki, zonë për parkimin e makinave të administratës. Ky shesh gjithashtu në raste të caktuara duhet të konceptohet që të përdoret për aktivitete të ndryshme artistike që do të zhvillohen në qytet.

Lidhur me hartimin e projektit të rehabilitimit të parkut "Geraldine" dhe rikonceptimin dhe rehabilitimin e sheshit përpara Bashkisë Burrel, nga ana e bashkisë na janë vënë në dispozicion të dhënat e mëposhtme:

- I. Plani i përgjithshëm vendor për planifikimin e territorit të njësisë vendore bashkia Burrel, në format DWG.
- II. Rilevimin topografik i parkut "Geraldine".
- III. Rilevimin topografik i sheshit përpara Bashkisë Burrel në format DWG.
- IV. Rrjeti i kanalizimit të ujërave të përdorura në format DWG

1.2 Raporti i vrojtimit të infrastruktures

Në paragrafët e mëposhtëm jepet në mënyrë të detajuar raporti i vrojtimit për secilin objekt

1.2.1 Rehabilitimi i parkut publik "Geraldine"

Parku "Geraldine" shtrihet në afërsi të qendrës së qytetit të Burrelit dhe zë një hapësirë afërsisht 30,000m². në brendësi të këtij parku gjenden dy objekte një xhami dhe një lokal në periferi të tij në anën lindore, shih Figura 4-3; Figura 4-4.

Rruga kryesore e këtij parku është e shtruar me asfalt i cili duket në një gjendje të mire, shih Figura 4-1. Por në disa pjesë të tij dallohen dhe prania e gropave. Rrugicat e parkut janë kryesisht të shtruara me beton ose me granit një pjesë e tyre ishte e dëmtuar, shih Figura 4-2; Figura 4-4. Rrugakryesore ka edhe bordura betoni (shih Figura 4-1; Figura 4-2) të cilat përgjithësisht janë në gjendje të mire.

Përsa i përket lëvizjes në parku në rrugën kryesore të tijë vihej re edhe lëvizja e veturave që shkonin për frekuentimin e lokalit. në këtë rrugë si edhe në gjithë parkun mungonin shenjat e sinjalistikës, shih Figura 4-1.

Ndriçimi i parkut nuk është i mjaftueshëm. Vetëm rruga kryesore e parkut është e ndriçuar dhe zona afër lokalit dhe pranë xhamisë, shih figurat në vijim.

Parku nuk duket të jete i pajisur me një sistem të kullimit të ujerave të shiut pasi në të nuk u vu re asnjë puset apo dhe kunetë përgjatë rrugicave.



Figura 4-1- Parku “Geraldine”. Pamje e rrugës kryesore



Figura 4-2 Rrugica në park



Figura 4-3 Pamje e Xhamisë në park



Figura 4-4- Pamje e lokalit në park

1.2.2 Rikonceptimi dhe Rehabilitimi i sheshit përpara Bashkisë Burrel

Sheshi para Bashkisë së Burrelit ka një sipërfaqe prej afërsisht 4 900m² dhe është i shtruar plotësisht me asfalt, shih Figura 4-5; Figura 4-6; Figura 4-7; Figura 4-8.

Asfalti i sheshit është i dëmtuar në pjesën më të madhe tij (shih figurat në vijim) dhe në vende të caktuara shihet dhe prania e gropave, shih Figura 4-8. Kryesisht është e dëmtuar shtresa veshëse e asfaltit. Sheshi ka një pjerrësi uniforme në të gjithë hapësirën e tij.

Përsa i përket trafikut ky shesh aktualisht është i frekuentuar nga automjete dhe këmbësore (shih figurat në vijim) dhe ka një mungesë të theksuar të sinjalistikës rrugore duke e bërë e paqarte qarkullimin e makinave.

Nën këtë shesh ndodhet një sistem i shkarkimit të ujerave të zeza gjë që tregohet dhe nga prania e puseta në të, shih Figura 4-6 si edhe nga materialet e vena në dispozicion. Gjatë investigimit nuk u vu re ndonjë pusëtë e kullimit të ujërave të shiut.

Ndriçimi i sheshit nuk është i plotë pasi siç mund të shikohet dhe në figurat në vazhdim ky ndriçim është i limituar vetëm në pjesën pranë ndërtesave duke e lënë pjesën qendrore të sheshit të pandriçuar.

Përsa i përket parkimit që është planifikuar të ndërtohet në këtë zonë për punonjësit e bashkisë është e nevojshme të specifikohet pozicioni i sakte i tij si dhe numri dhe tipat e automjeteve që do të parkohen



Figura 4-5 Sheshi përpara Bashkisë Burrel



Figura 4-6 Sheshi përpara Bashkisë Burrel



Figura 4-7 Shtresa asfaltike të dëmtuara të sheshit



Figura 4-8 Shtresa asfaltike të dëmtuara të sheshit

1.3 Raporti i hulumtimit hidroteknik

Lidhur me gjendjen e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut dhe ujërave të përdorura si edhe me gjendjen e rrjetit të ujësjellësit nga inspektimi në vend si edhe nga materialet e vena në dispozicion nga Bashkia e Burrelit arrijmë në përfundimet e mëposhtme:

Rrjeti shkarkimit të ujërave atmosferik mungon plotësisht, dhe për kullimin e tyre shfrytëzohet pjerrësia e terrenit i gjithë sheshi dhe parku kanë një pjerrësi natyrale rreth 3-4% me rënie në drejtim të Jug-Lindjes si edhe prezenca e rrjetit të ujërave të përdorura, për të cilin kemi vetëm një informacion grafik.

Nuk ka informacion as për rrjetin e ujësjellësit por duke gjykuar nga prezenca e objekteve përreth sheshit dhe parkut mund të shfrytëzohen ato linja edhe për parkun.

Lidhur me rrjetin e ujësjellësit i vetmi informacion është ai sipas të cilit ky rrjet është rehabilituar tërësisht në vitet 2004-2005

1.4 Hartimi i Projektit

1.4.1 Projektimi I trashësisë së shtresave

Faktorët të cilët ndikojnë në performancën e rrugëve dhe trotuareve përfshijnë nën shtresën bazë (sub-grade) mbi të cilin struktura e paketës së shtresave mbështetet, cilësia e materialeve të përdorura për ndërtimin e paketës së shtresave, trashësinë e shtresave, dhe llojin dhe sasinë e trafikut që përdoret në objekt. Në projektimin e paketës së shtresave, e cila do të sigurojë një shkallë të arsyeshme të performancës së saj gjatë jetëgjatësisë projektues, në qoftë se është përcaktuar nga këta faktorë të mësipërm atëherë mund të jetë e paracaktuar. Kapaciteti mbajtës I ngarkesës për nën shtresën bazë ku mbështetet paketa e shtresave të rrugës ose trotuarit mund të përcaktohet duke e bërë një investigim inxhinierie I tokës në vendin ku propozohet të vendoset paketa e shtresave e rrugës apo trotuarit. Kapaciteti i paketës së shtresave që do të përdoret, gjithashtu mund të përcaktohet me specifikimet dhe kontrollin e cilësisë gjatë fazës së ndërtimit. Një vlerësim I arsyeshëm mund gjithashtu të bëhet duke përfshirë trafikun me një numër ekuivalent të ngarkesës aksiale prej 80kN të parashikuar gjatë jetës së trotuarit. Me rëndësi primare në përcaktimin e ngarkesave të trafikut është shuma e pritur e trafikut nga lëvizjet e kamionëve dhe autobusëve në rrugë gjatë jetës.

Të dhëna të rekomanduara për llogaritjen e trashësive të shtresave të paketës, për rrugët dhe trotuaret janë bazuar në: “Manual I projektimin të shtresave” dhe janë siç jepen më poshtë:

Volumi total i trafikut:	500 Mjete për një ditë (Vpd)
Korsitë e trafikut:	Një korsi
Gjerësia e trotuareve:	3m-5m
Trafiku nga kamionët e mbeturinave:	Supozohet 3 kamionë në javë
Kamionët e plehrave:	35.6kN aks i vetëm dhe 140kN për dobio aks
Trafiku (Korsia projektuese):	64,876 80 kN ESAL

Pas llogaritjeve, trashësia minimale për shtresat e rrugëve dhe trotuareve janë:

	Kërkesat për nën shtresën e bazës (Subgrade)		Shtresa e bazës	Shtresa me gurë (kalldrëm)
	PI =15 ose më pak	PI =më e madhe se 15		
Rrugët	15 cm	20 cm	5 cm	15-20 cm
Trotuarët	Ngjeshur	Ngjeshur	5 cm	15-20 cm

PI - është treguesi i plasticitetit për nën shtresën e bazës (Subgrade)

Ngjeshja standarde e nën shtresës së bazës (sub-grade) nën rrugice dhe torture është 98% standarde. Dendësia e mbikëqyrur në minus 2% deri në 4% të lagështisë optimale në thellësinë e përcaktuar

1.4.2 Infrastruktura rrugore

Sheshi Perpara Bashkise:

Zgjidhja përfundimtare e sheshit kryesorë përpara bashkisë së qytetit:

1. Rikonceptimi në plan i sheshit konsiston transformimin rrënjësor të tij, në prishjen e shtresave asfaltike ekzistuese dhe shtrimin e tyre me pllaka guri.




Figura 4-9-Ndërhryrjet në sheshin përpara Bashkisë

3. Nga pikëpamja e shtresave janë parashikuar sa më poshtë:

Ndërtimi i një pakete shtresash “rigjide” me pllaka guri natyral kryesisht me formë të rregullt (të skuadruar) dhe të vendosur në radhë me dimensionin më të madh të tyre sipas drejtimit tërthor të rrugës:

Pllaka guri 5-8 cm (Shtresa veshëse)

Llaç çimento 4cm (për nivelim e fiksimin e gurëve, në rolin e shtresës bazë) Beton arme
10cm (për nivelim, në rolin e shtresës bazë)

Nënshtresë 20cm me stabilizant (për profilin e rrugës dhe në rolin e Sub base) Toka natyrale
e ngjeshur - cm (për vendosjen e paketës së shtresave)




Figura 4-10-Paketa e shtresave e përdorur në shesh




Figura 4-11-Paketa e shtresave e përdorur përballë ALB-Telecom

4. Bordurat e rrugëve parashikohen të realizohen gjithashtu prej guri siç tregohen në vizatime.




Figura 4-12-Detaji i bordurës së përdorur

5. Në të gjithë hapësirën e sheshit janë respektuar me korrektësi pozicionet e trotuareve ekzistues ndonëse ka përmirësim lidhur me drejtimin e tyre.
6. Ndërhyrjet në degëzime janë parashikuar mesatarisht deri në 10m
7. Ndërtimi i sistemit të kullimit të ujërave të shiut

Parku "Geraldine":

Propozimet lidhur me punimet e parashikuara për tu realizuar në parkun "Geraldine":

1. Ri veshja e rrugës kryesore, dhe unazë së parkut, me shtresa asfaltike.
2. Rindërtim i shtresave të rrugicave të parkut me granit




Figura 4-13-Seksioni TIP tërthorë i rrugës në park

3. Nga pikëpamja e shtresave janë parashikuar sa më poshtë:

Ndërtimi i një pakete shtresash “rigjide” me pllaka guri natyral kryesisht me formë të rregullt (të skuadruar) dhe të vendosur në radhë me dimensionin më të madh të tyre sipas drejtimit tërthor të rrugës:

Pllaka guri 4-6 cm (Shtresa veshëse)

Llaç çimento 4cm (për nivelim e fiksimin e gurëve, në rolin e shtresës bazë) Nënshtrësë 20cm me stabilizant (për profilimin e rrugës dhe në rolin e Sub base) Toka natyrale e ngjeshur - cm (për vendosjen e paketës së shtresave)




Figura 4-14-Paketa e shtresave e përdorur në park

4. Bordurat e rrugëve parashikohen të realizohen gjithashtu prej guri siç tregohen në vizatime.




Figura 4-15-Detaji i bordurës së përdorur

- Në të gjithë gjatësinë e rrugës janë respektuar më korrektësi pozicionet e rrugicave dhe trotuareve ekzistues.
- Vendosja e sinjalistikës rrugore është e nevojshme, për rastin e rrugëve ku si kriter kryesor bazë është kufizimi në maksimum i lëvizjes së automjeteve. Nëpërmjet kësaj sinjalistike do ti jepet gjithmonë prioritet lëvizjes së këmbësorëve. Sinjalistika do të jetë vertikale me tabela ndërsa ajo horizontale do të krijohet me anë të teksturës së rrugës.

1.5 Kriteret dhe Normat e Projektimit

Për projektimin e rrugëve të këtij projekti do të mbështetemi në materialet e mëposhtme:

- Kushte Teknike Të Projektimit Të Rrugëve Automobilistike 2002
- Udhëzues për ndërtimin e rrugëve 1983
- ARDM, (Standardet për Projektimin dhe Ndërtimin e Rrugëve Shqiptare (MPRrSSH)
- ASHTO, (Chapter 2 Design Controls And Criteria/ The Pedestrian)
- Paving design manual the city of Dallas